



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QËNDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA JURIDIKE DHE PROKURIMEVE

Nr. 4820/ Prot.

Tiranë, më 07.11.2018

Lënda: Dërgohet për zbatim Urdhëri i Përbashkët nr. 709, datë 10.10.2018 i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Minisatrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë"

DREJTORISË EKONOMIKE DHE PLANIFIKIMIT FINANCIAR

DREJTORISË SË BURIMEVE NJERËZORE

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË IT DHE INXHINJERISË KLINIKE

DREJTORISË SË PERFORMANCËS SPITALORE

DREJTORISË SË SHËRBIMIT FARMACEUTIK


SEKTORIT TË AUDITIT

Bashkëlidhur ju dërgojmë për zbatim Urdhërin e Përbashkët nr. 709, datë 10.10.2018 i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Minisatrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë".

Mbani parasysh të bëni ndryshimet përkatëse, ishte "Statuti i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" me Nr. 2364 Prot, dt 25.06.2007 të Ministrisë të Shëndetësisë, dhe Nr. 4564/1 prot, dt 26.06.2007 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës", bëhet "Urdhëri i Përbashkët nr. 709, datë 10.10.2018 i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Minisatrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë".

Me respekt,

DREJTORI PËR QËNDRA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

4820
06.11.18

Tiranë, më 02.11.2018

Nr. 5842/prot.
2

Lënda: Dërgohet për kompetencë Urdhri i Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.

Z. ENKELEJDI JOTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË ✓

I nderuar Z. Joti,

Bashkëlidhur ju dërgojmë për kompetencë, Urdhrin e Përbashkët Nr. 709, datë 10.10.2018, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

ARIAN KRAJA



Dr. Jurisdike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE

Nr. 5842 Prot.
Datë 0.10.2018

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË

Nr. 10762 Prot.
Datë 30.10.2018

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 709 Datë 01.10.2018

PER

MIRATIMIN E STATUTIT TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE, "NËNË TEREZA", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr.10107, datë 30.03.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të pikës 8, të Vendimit Nr.66, datë 03.02.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare" dhe pikës 2 të Vendimit Nr.654, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza",

URDHËROJMË:

1. Miratimin e Statutit të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, sipas tekstit dhe Shtojcës Nr. 1 bashkëlidhur këtij Urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË

LINDITA NIKOELA

STATUTI

I

QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"

TIRANË

Kreu I

DISPOZITA THEMELORE

1. Objekti i veprimtarisë dhe statusi juridik:

1.1 Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" është strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

1.2 Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, e cila organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

1.3 QSU Nënë Tereza ushtron veprimtarinë e saj, sipas Ligjit Nr.10107, datë 30.03.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 123/2014 "Për urdhrin e mjekëve të Shqipërisë", Ligjin Nr. 9718, datë 19.04.2007, "Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 9150, datë 30.10.2003, "Për urdhrin e farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 10383, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH", VKM nr. 66, datë 03.02.2017, "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimit të shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare", VKM Nr. 654, datë 10.11.2017. "Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare, "NËNË TEREZA".

1.4 Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" identifikohet zyrtarisht nga emërtimi i plotë i saj ose nga akronimi QSU "Nënë Tereza".

- 1.4 Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", është e organizuar nga shërbimet universitare dhe njësi mjekësore, të cilat nga natyra e specialitetit mjekësor/klinik që trajtojnë, kanë lidhje funksionale me shërbimet shëndetësore universitare. Këto njësi realizojnë shërbime shëndetësore, funksione diagnostikuese e trajtuese. Njësitë mjekësore duhet të jenë të pajisura me jo më pak se 10 shtretër.

2. Të dhënat identifikuese:

- 2.1 Selia e QSU "Nënë Tereza" është në Tiranë, në adresën "Rruga e Dibres" Nr. 372, Tirane ku është vendndodhja e organit të vet përfaqësues
- 2.2 Emblema e QSU-së paraqet siluetën e stilizuar të selisë me nën-shkrimin me shkronja kapitale "QENDRA SIPTALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA", sipas modelit bashkëlidhur statutit me shtojcën nr.1, me raportin gjerësia 1/gjatësia 2.5.
- 2.3 Vula e QSU "Nënë Tereza" ka formë rrethore/elipëke, në qendër dhe rreth-shkrimin me shkronja kapitale/ shtypi.

3. Misioni dhe objektivi:

3.1 Misioni i QSU "Nënë Tereza" është:

- Të ofrojë shërbimin mjekësor me përkushtim, profesionalizëm dhe cilësi të lartë, duke vënë në dispozicion të të sëmurëve maksimumin e kapaciteteve njerëzore, dijeve dhe faciliteteve që disponon;
- Të japë ndihmë mjekësore të specializuar (terciare) për gjithë banoret e vendit dhe shërbim mjekësor dytësor për banoret e Tiranës, duke shërbyer me profesionalizëm sipas rregullave të deontologjisë dhe të etikës mjekësore si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe informacionin e pacientëve;
- Të trajtojë dhe t'u shërbejë të sëmurëve, sipas gjëndjes dhe nevojave psikologjike dhe fizike, me standartin më të lartë deontologjik, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e të sëmurëve, si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe privatësinë e pacientëve;
- Të shërbejë si bazë pedagogjike për formimin e studentëve të Mjekësisë, formimin e vazhdueshëm të mjekëve dhe specializantëve.
- Të shërbejë si bazë kërkimore-shkencore në fushën e shëndetësisë, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë Tiranës dhe struktura të tjera kërkimore shkencore.

- 3.2 Objektivi i QSU "Nënë Tereza", është që nëpërmjet administrimit efektiv dhe eficient të burimeve, shfrytëzimit të mekanizmave të përmirësuar të financimit, zhvillimit të

standardeve, rritjes së kapaciteteve e kompetencave, futjes së teknikave e praktikave të reja diagnostikuese e mjekuese, të realizojë trajtim mjekësor cilësor dhe konkurrues, të rrisë përkujdesin ndaj të sëmurëve dhe trajtimin me sukses të sëmundjeve të tyre, si dhe të konsolidojë statusin e një qendre prioritare kompetence dhe ekselence në fushën e shkencave mjekësore.

4. Burimet e financimit të QSU "NËNË TEREZA"-së:

4.1 Burimet e financimit të QSU "Nënë Tereza", përbëhen nga:

- Buxheti i shtetit;
- financimet;
- donacionet;
- të ardhurat e krijuara nga institucioni.

4.2 QSU "Nënë Tereza" financohet nga buxheti i shtetit dhe Fondi i Detyrueshëm i Sigurimeve Shëndetësore FSDKSH, sipas kontratës së financimit të nënshkruar midis dy palëve, e cila është e vlefshme për një periudhë një vjeçare.

4.3 Mënyra dhe forma e financimit të spitalit përcaktohet në kontratën e lidhur midis QSU "Nënë Tereza" dhe FSDKSH.

4.4 QSU "Nënë Tereza", siguron të ardhura (dytësore) nga çdo shërbim mjekësor të dhënë sipas tarifave të miratuara nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë.

4.5 Të ardhurat e siguruar janë pjesë e buxhetit të spitalit. Këto të ardhura përdoren sipas legjislacionit në fuqi.

4.6 Përgjegjës për arkëtimet e të ardhurave, kundrejt faturave të unifikuara janë shërbimet e receptionit të ngritura në QSU "Nënë Tereza".

~~4.7 QSU "Nënë Tereza" mund të kërkojë dhe pranojë mbështetje financiare edhe nga donatorë të ndryshëm, vendas apo të huaj.~~

4.8 Kosto e shërbimit për një pacient llogaritet sipas të dhënave të kartelës së tij personale sipas elementeve të sistemit të unifikuar të kostos dhe bëhet, jo më vonë se një muaj nga dita e mbarimit të trajtimit të tij në spital.



4.9 Të gjitha dokumentat që paraqiten në sistemin shëndetësor njihen dhe vlerësohen sipas rregullores së brendshme të funksionimit të QSU "Nënë Tereza",

4.10 Të dhënat personale të pacientëve ruhen sipas Ligjit Nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

~~4.11 Financimet formohen nga shpenzimet kapitale për investimet në QSU "Nënë Tereza", të kryera nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, nga fondet e veta buxhetore.~~

5 Asetet e QSU "NËNË TEREZA":

5.1 Për ushtrimin e veprimtarisë QSU "Nënë Tereza", mban dhe zhvillon asete në formën e pasurive të paluajtshme, infrastrukturës shëndetësore, pajisjeve mjekësore dhe ndihmëse, mallrave dhe likuiditeteve.

5.2 Pasuritë e paluajtshme të QSU "Nënë Tereza", janë prona të paluajtshme të shtetit, të cilat i janë dhënë QSU-së në përgjegjësi administrimi. Administrimi i tyre bëhet, duke ruajtur dhe garantuar interesin publik dhe duke ruajtur dhe rritur vlerën ekonomike të tyre.

5.3 Për shtimin dhe përmirësimin e aseteve, si dhe rritjen e vlerës ekonomike të tyre, QSU "NËNË TEREZA" hyr në marrëdhënie juridike kontraktuale me palë të treta, brenda kufijve dhe sipas legjislacionit për menaxhimin dhe kontrollin financiar.

Kreu II

MARRËDHËNIET ME UMT DHE PALËT E TRETA

6 Marrëdhëniet me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë:

6.1 QSU "Nënë Tereza", bashkëpunon në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor me departamentet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, që përbëhen nga shërbime në bazë specialiteti.

6.2 Departamentet propozojnë fushat e mësimdhënies e të kërkimit shkencor për shërbimet shëndetësore universitare, që ofron Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", të cilat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

6.3 Punësimi i pedagogëve të Universitetit Mjekësor Tiranë bëhet me kontratë shërbimi. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti i QSU "Nënë Tereza".



7. Marrëdhëniet me koncesionarët dhe kontraktuesit:

Marrëdhëniet e QSU "Nënë Tereza" me operatorët privatë që ofrojnë mallra dhe shërbime për llogari ose në dobi të QSU "Nënë Tereza" rregullohen nga kontratat respektive, pavarësisht nëse QSU "Nënë Tereza", është palë nënshkruese e tyre ose jo.

Në rastet kur QSU "Nënë Tereza" nuk është palë nënshkruese, ajo njihet me detyrimet nëpërmjet vënies në dispozicion të kontratës së nënshkruar nga palët.

Kreu III

ORGANIZIMI

8. Organet Drejtuese:

Organet drejtuese të QSU "Nënë Tereza", janë:

- Bordi
- Drejtoria e Përgjithshme;
- Komisioni mjekësor.

9. Bordi :

9.1. QSU "Nënë Tereza", drejtohet nga Bordi dhe Drejtoria e Përgjithshme. Bordi miraton politikat dhe strategjinë e zhvillimit, si dhe miraton programet tekniko-financiare të veprimtarisë së QSU-së, në përputhje me politikat qeverisëse për shëndetësinë, arsimin e lartë e kërkimin shkencor, si dhe planin e zhvillimit strategjik të universitetit e të fakulteteve të fushës së shëndetit.

9.2 Bordi kryesohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ka në përbërje katër anëtarë:

a) Përfaqësuesin nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin;

b) Përfaqësues nga institucioni i arsimit të lartë mjekësor.

c) Kryetarin e Komisionit Mjekësor;

ç) Përfaqësuesin nga Institucioni që financon kujdesin shëndetësor (FSDKSH).

9.3 Bordi mbledhet jo më pak se 3 herë në vit. Rendi i ditës propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohet nga Bordi. Mbledhjet thirren nga kryetari i Bordit

irregullisht ose në raste të jashtëzakonshme. Mbledhjet e Bordit zhvillohen kur janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të jetë pjesëmarrës në çdo mbledhje të Bordit, pa të drejtë vote.

10. Bordi i QSU "Nënë Tereza" ka këto funksione dhe përgjegjësi:

- a) Miraton projektbuxhetin, strukturën dhe organikën administrative, strukturën shëndetësore universitare dhe numrin e personelit të shërbimeve shëndetësore universitare;
- b) Miraton raportin e veprimtarisë shëndetësore dhe kërkimore shkencore të shërbimeve shëndetësore universitare;
- c) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare;
- ç) Miraton rregulloret e funksionimit të QSU "Nënë Tereza".
- d) Miraton rregullat dhe procedurat e punësimit të QSU "Nënë Tereza" dhe kërkon raport nga Drejtori i Përgjithshëm për zbatimin e tyre;
- dh) Miraton kryerjen e investimeve kapitale me fonde të QSU-së, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm;
- ~~e) Miraton kriteret për dhënie të mjediseve me qira dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve për të tretë;~~
- e) Vlerëson dhe miraton procedurën mbi përdorimin apo nxjerrjen jashtë përdorimit të Aseteve të QSU "Nënë Tereza", me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm;
- f) Propozon për miratim projektstatutin e Qendrës Spitalore Universitare kryen funksione të tjera, që burojnë nga ligji, statuti dhe rregulloret e QSU-së;
- g) Zgjedh anëtarët e Komisionit Mjekësor të QSU "Nënë Tereza", sipas propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme.

11. Kompetencat për mbledhjen e Bordit

- 11.1 Bordi thirret nga Kryetari i Bordit dhe njoftohet me shkrim të paktën 7 ditë përpara, duke bërë të ditur dhe rendin e ditës. Gjithashtu, në raste të tjera, mbledhjet e bordit



mund të thirren nga Drejtori i Përgjithshëm i QSU-së, kur kërkohen vendimarrje të shpejta për çështje të ndryshme, të cilat janë në kompetencë të Bordit.

11.2 Mbledhja zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve, në rast të kundërt mbledhja shtyhet për ditën tjetër, duke përsëritur lajmërimin. Për mbledhjen e Bordit mbahet procesverbal nga një person i përhershëm, i autorizuar nga kryetari, i cili zgjidhet nga administrata e spitalit. Drejtori i Përgjithshëm është i pranishëm në mbledhjet e Bordit pa të drejtë vote. Vendimet e Bordit nënshkruhen nga kryetari dhe depozitohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme.

11.3 Vendimet e Bordit merren me shumicë votash. Çdo anëtar i Bordit ka të drejtën e një vote dhe nuk i lejohet abstenimi. Kur votat barazohen, vota e kryetarit është vendimtare.

12. Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Bordit

12.1 Mandati i anëtarëve të Bordit përfundon ose ndërpritet kur:

- a) Dënohen me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e veprave ose kundravajtjeve penale;
- b) Japin dorëheqjen;
- c) Ndryshojnë vendin e punës ose subjektin që përfaqësojnë;
- c) Bëhen të paaftë, sipas legjislacionit në fuqi, për të ushtruar mandatin.

13. Drejtoria e Përgjithshme:

13.1 Drejtoria e Përgjithshme siguron drejtimin administrativ dhe institucional të QSU "Nënë Tereza". Ajo drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtoria menaxhon aktivitetin e përgjithshëm të shërbimeve, programon orientimet strategjike dhe siguron zbatimin e tyre.

13.2 Drejtoria e Përgjithshme përbëhet nga:

Drejtori i Përgjithshëm;

Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm.

13.3 Janë kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme:

- a) Hartimi i projekt-buxheteve dhe paraqitja për miratim në bord;
- b) Hartimi i projekt-statutit dhe i projekt-rregulloreve të brendshme të QSU "Nënë Tereza" në përputhje me ligjet në fuqi;



- c) Hartimi i projekteve të strukturës së shërbimeve dhe strukturës administrative të QSU "Nënë Tereza";
- ç) Hartimi i normativave të personelit të lartë, të mesëm dhe jomjekësor;
- d) Drejtim i formimit tekniko-profesional të personelit të lartë dhe të mesëm të institucionit;
- dh) Analiza e treguesve tekniko-financiarë të çdo tremujori dhe raportimi përpara Bordit për performancën mjekësore dhe tekniko financiare të QSU "Nënë Tereza";
- e) Prezantimi para Bordit i problematikave të shërbimit shëndetësor dhe tekniko-administrativ dhe i propozimeve për adresimin e tyre;
- ë) Hartimi i projekteve dhe prezantimi i tyre për miratim në bord;
- f) Propozimi i kandidaturave për anëtarë të Komisionin Mjekësor të QSU "NËNË TEREZA"-së, të cilat i dërgohen Bordit me një listë jo më të vogël së dyfishi i numrit të vendeve që duhet të plotësohen, në të cilën kandidatët shefa shërbimesh nuk mund të jenë më shumë se 50 për qind.

14. Drejtori i Përgjithshëm i QSU "Nënë Tereza":

14.1 Drejtori i përgjithshëm është autoriteti më i lartë administrativ i QSU "Nënë Tereza".

Ai menaxhon aktivitetin e përgjithshëm të institucionit sipas shërbimeve dhe siguron zbatimin e objektivave të institucionit bazuar në strategjinë e zhvillimit të tij, nëpërmjet strukturave në varësi. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe me të tretë.

14.2 Drejtori i Përgjithshëm siguron zbatimin e Statutit dhe rregulloreve të brendshme të QSU "Nënë Tereza" dhe ka autoritet administrativ dhe institucional mbi të gjithë personelin.

14.3 Drejtori i Përgjithshëm i QSU "Nënë Tereza" emërohet nga ministri i përgjegjës për shëndetësinë sipas legjislacionit në fuqi.

14.4 Paga e Drejtorit të Përgjithshëm caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

14.5 Drejtori i Përgjithshëm asistohet në veprimtarinë drejtuese nga zëvendës drejtorët teknikë, të cilët ngarkohen me përgjegjësi organizative dhe monitoruese për aspektet mjekësore të institucionit.

14.6 Drejtori i Përgjithshëm raporton para Bordit dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë, administrimin dhe çështjet organizative që lidhen me detyrën e tij.

15. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm:

15.1 Drejtori i përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

- a) Përgatit mbledhjet e Bordit, me rendin e ditës dhe materialet, dhe merr pjesë në çdo mbledhje, pa të drejtë vote;
- b) Drejton punën për zbatimin e vendimeve të Bordit dhe çdo detyrimi që i ngarkohet QSU "Nënë Tereza" nga legjislacioni në fuqi;
- c) Vendos për të gjitha çështjet e administrimit të QSU "Nënë Tereza", organizon, drejton dhe raporton mbi veprimtarinë ekonomike-financiare të saj;
- ç) Ndjek realizimin e treguesve të efektivitetit të punës në QSU-së, bazuar në indikatorët e miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë;
- d) Propozon në Bord buxhetin e QSU "Nënë Tereza", programin financiar dhe paraqet raportin vjetor;
- dh) Është Kryetar i Autoritetit Kontraktues të QSU "Nënë Tereza", si dhe Kryetar i Komisionit Kombëtar Ndërsptalor për trajtimin e shtetasve shqiptarë të sëmurë që kanë nevojë për trajtim jashtë vendit;
- e) Emëron të gjithë punonjësit e QSU "Nënë Tereza", sipas procedurave të përcaktuara në ligj, apo akteve nënligjore të miratuara për këtë qëllim, përfshirë personelin e lartë mjekësor dhe jo mjekësor si dhe personelin pedagogjik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë për shërbimin që kryen në Spitalin Universitarë sipas nevojave të QSU "Nënë Tereza";
- ë) Merr dhe zbaton masat disiplinore, në rast shkeljesh të Kodit të Punës, kontratës dhe rregullores së shërbimeve nga ana e personelit të lartë, të mesëm dhe jo mjekësor të QSU "Nënë Tereza, përfshirë të drejtën e shkarkimit, pezullimit të punonjesve, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Në rast shkeljeje të etikës, deontologjisë dhe rregullores së spitaleve universitare nga studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i propozon Dekanit marrjen e masave disiplinore;
- f) Negocion dhe lidh kontrata me palë të treta, brenda kufijve të legjislacionit në fuqi, si dhe kritereve të vendosura nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, me qëllim administrimin efektiv dhe eficient të burimeve, përfshirë dhënien me qera të

mjediseve, truallit, infrastrukturës apo pajisjeve mjekësore, apo ofrimin e shërbimeve dhe kapaciteteve për të tretë;

g) Drejtori i Përgjithshëm koordinon lidhjen ndërmjet QSU "Nënë Tereza dhe pushtetit vendor si dhe homologëve të tij të brënda dhe jashtë spitalit;

gj) Koordinon aktivitetin spitalor në bashkëpunim me zëvendësdyrejtorët e përgjithshëm teknikë dhe drejtuesit mjekësorë të Poleve të Administrimit të Integruar (PADI).

16. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtën e delegimit të kompetencave të tij tek zëvendësdyrejtorët e përgjithshëm teknikë apo dyrejtorët e dyrejtorive sipas rastit.

17. Zëvendësdyrejtorët e Përgjithshëm:

17.1 Zëvendësdyrejtorët e Përgjithshëm emërohen dhe lirohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

17.2 Zëvendësdyrejtorët e Përgjithshëm mbulojnë detyrat vijuese:

a) Organizojnë aktivitetin profesional dhe tekniko-shkencor të QSU "Nënë Tereza";

b) Ndjekin, në bashkëveprim me shefat e shërbimeve, kualifikimin profesional e shkencor të mjekëve dhe personelit të mesëm infirmieror mjekësor;

c) Mbikëqyrin organizimin dhe drejtimin e punës aspektin mjekësor në QSU "Nënë Tereza";

d) Organizojnë dhe bashkërendojnë punën me Dyrejtorinë Farmaceutike të QSU "Nënë Tereza" në fushën e furnizimit, shpërndarjes dhe konsumit të barnave dhe materialeve mjekësore;

e) Organizojnë dhe drejojnë punën për hartimin, miratimin dhe zbatimin e protokolleve të diagnostikimit dhe të mjekimit për çdo shërbim;

f) Organizojnë dhe drejojnë punën në sektorët e laboratorëve, imazherisë mjekësore, biomedikalit dhe në ato të mirëmbajtjes teknike;

g) Organizojnë dhe drejojnë punën e sektorit të higjenës dhe të parandalimit të infeksioneve nozokomiale;

h) Organizojnë studime mbi sëmundshmërinë e vdekshmërinë dhe përcaktojnë masat për uljen e tyre në QSU "Nënë Tereza";

17.3 Ndarja e detyrave midis tyre bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas parimit të kompetencës profesionale dhe barazpeshës së ngarkesës.

~~18. Komisioni Mjekësor i QSU "NËNË TEREZA":~~

18.1 Komisioni Mjekësor është organ këshillimi teknik i Drejtorisë së Përgjithshme dhe përbëhet nga drejtorët e spitaleve, që funksionojnë brenda autoritetit spitalor të qarkut dhe shefat e shërbimeve ose përfaqësues të zgjedhur nga vetë shërbimet e këtyre spitaleve.

18.2 Komisioni Mjekësor kryesohet nga kryetari i zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të kritereve të vendosura nga ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ushtron veprimtarinë e tij për tre vjet.

18.3 Komisioni Mjekësor përbëhet nga 26 antare, të cilët zgjidhen nga Bordi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas formulës: Drejtoria i propozon Bordit kandidaturat për anëtarë të Komisionin Mjekësor të QSU "NËNË TEREZA"-së, me një listë jo më të vogël se dyfishi i numrit të vendeve që duhet të plotësohen; në të cilën kandidatët shefa shërbimesh nuk mund të jenë më shumë se 50 për qind.

18.4 Komisioni Mjekësor konsulton lidhur me aspektet mjekësore të punës, me përshkrimin e detyrave sipas funksioneve, dhe organizimin e shërbimeve mjekësore;

18.5 Komisioni Mjekësor konsulton për projektet dhe politikat e zhvillimit të QSU "NËNË TEREZA", jep mendim për mbylljen, modifikimin apo krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për vendosjen e tarifave mjekësore;

18.6 Komisioni Mjekësor thirret në mbledhje nga Drejtori i Përgjithshëm. Në mbledhjet e Komisioni Mjekësor marrin pjesë dhe zëvendësdrejtorët.

~~19. Organigrama e QSU "NËNË TEREZA":~~

~~19.1 Organigrama e QSU "NËNË TEREZA"-së është pjesë e këtij statuti, e përfshirë si shtojcë e veçantë e tij. Ndryshimi i strukturës së QSU "NËNË TEREZA" reflektohet automatikisht në organigramën e QSU "NËNË TEREZA" dhe në këtë statut, pa pasur nevojën e amendimit formal të tij.~~

19.2 Organigrama pasqyron strukturën administrative dhe të shërbimeve mjekësore.



20. Polet e Administrimit të Integruar:

20.1 Struktura e Shërbimit Mjekësor të QSU "NËNË TEREZA" organizohet në tetë pole shërbimesh, të quajtur Polet e Administrimit të Integruar (PAI), qëllimi i të cilave është të optimizojë proceset e punës për të siguruar shërbime mjekësore të përshtatshme dhe cilësore për pacientët.

20.2 Polet e Administrimit të Integruar janë:

- Poli i Administrimit të Integruar të Sëmundjeve të Brendshme.
- Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent.
- Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës.
- Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit Pediatrisë.
- Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit Onkologjik.
- Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit Francez.
- Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit Infektiv.
- Poli i Administrimit të Integruar të Konsultave.

20.3 Çdo PAI ka në përbërjen e tij drejtuesin mjekësor, administratorin si dhe një strukturë ndihmëse, që ndjek planifikimin e shërbimeve për çdo spital për të zhvilluar, monitoruar dhe mbajtur përgjegjësi për çdo aktivitet spitalor dhe ambulator.

20.4 Organizimi me PAI ka në bazë të tij parimin e pjesëmarrjes së profesionistëve në procesin e vendimmarrjes dhe përfaqëson grupimin e specialiteteve të përafërta.

20.5 Administratori organizon punën në kuadër të koordinimit me pacientët, mjekët dhe familjarët, administron ankesat dhe kërkesat e pacientëve, duke koordinuar me shërbimet mjekësore dhe stafin administrativ.

20.6 Funksionimi dhe drejtimi i Polit të Administrimit të Integruar bëhet në bazë të rregulloreve të posaçme.

21. Shërbimet Mjekësore:

21.1 Shërbimet mjekësore janë njësi të specializuara diagnostikuese, trajtuese, kuruese dhe shkencore themelore.

21.2 Shërbimi mjekësor ka personelin e vet me kohë të plotë e atë me kohë të pjesshme. Personeli është në varësi të drejtpërdrejtë funksionale të Shefit të Shërbimit, ndërsa për varësinë administrative të personelit veprohet njëllëj si për administratën.

21.3 Shefi i Shërbimit/eprosi direkt i mjekut ose infermierit mund të propozojë masë, përcaktimin e masës e merr Drejtori i Përgjithshëm.

21.4 Çdo Shërbim ka një Kryeinfermier, i cili/e cila përzgjidhet nga radhët e infermierëve të QSU "NËNË TEREZA", me përvojë pune së paku 3-vjeçare dhe kualifikimin më të lartë. Kryeinfermieri emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Numri i infermierëve, laborantëve apo i punonjësve të tjerë të Shërbimit caktohet sipas strukturës së miratuar nga Bordi.

21.5 Në çdo shërbim atashohen edhe specialistë që janë efektivë në shërbim të QSU "Nënë Tereza". Ata punojnë me kohë të plotë dhe me të njëjtën ngarkesë pune si mjekët e pavionit.

21.6 Drejtori merr masa për organizimin e shërbimeve mbështetëse, për të gjitha shërbimet në QSU "NËNË TEREZA", sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi. Funksionimi i tyre realizohet mbi bazën e një rregulloreje të veçantë të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

KREU IV

RREGULLA DHE PROCEDURA TË PUNËSIMIT DHE TË VLERËSIMIT NË PUNË

22. Kontrata e Punës

22.1 Të gjithë punonjësit në QSU "NËNË TEREZA" janë të punësuar me kontratë pune individuale sipas rregullave të Kodit të Punës.

22.2 Kontrata individuale e punës lidhet në pajtim të plotë me ligjin dhe kontratën kolektive të punës, për punonjësit e shëndetësisë që lidhet ndërmjet ministrit përgjigjës për shëndetësinë dhe sindikatës apo sindikatave.

22.3 Kontrata e punës së punonjësit të QSU "NËNË TEREZA" përmban detyrimisht këto elementë:

a) Objektin e Kontratës;

b) Kohëzgjatjen, pavarësisht nga afati;

~~c) Kohën e provës, kur kërkohet;~~

ç) Zgjidhjen e kontratës së punës;

d) Kohën e punës në QSU "NËNË TEREZA";

dh) Përshkrimin e vendit të punës dhe detyrat specifike (aneksi i kontratës së punës);

e) Detyrimet e punëmarrësit dhe punëdhënësit;

ë) Pagesa dhe shpërblimet në punë;

f) Procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

23. Dosja e Personelit

23.1 Për çdo punonjës në QSU "NËNË TEREZA", detyrimisht, krijohet një dosje personeli. Pedagogët duhet të dërgojnë në QSU "NËNË TEREZA", një dosje e cila të përmbajë aktivitetin e tyre pedagogjiko-shkencor. Mospërgatitja e dosjes për çfarëdo arsye do të konsiderohet shkelje e rëndë e disiplinës në punë dhe shkakton zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës, ose kur ajo nuk është lidhur ende, moslidhjen e saj.

23.2 Sektori i Personelit është njësia përgjegjëse në QSU "NËNË TEREZA" për mbajtjen e këtyre dosjeve me korrektësi, profesionalizëm dhe duke respektuar parimet e konfidencialitetit.

23.3 Dosja e të punësuarit në QSU "NËNË TEREZA" duhet të përmbajë detyrimisht:

a) Një kopje të kontratës së punës, së bashku me aktin e emërimit në rastin e drejtuesve;

b) Kopje e diplomës për personelin mjekësor si dhe kopje të dëftesave shkollore për personelin e ulët mjekësor;

c) Librezën e punës (origjinale);

ç) Librezën shëndetësore;

d) Dokumentin e gradës shkencore e pedagogjike;

dh) Vlerësimin e punës që bëhet në fund të çdo viti;



e) Aktet e masave disiplinore;

ë) Çdo dokument tjetër që lidhet me marrëdhëniet e punës dhe që kërkohet nga punëdhënësi.

24. Procedurat e marrjes në punë në QSU "NËNË TEREZA"

24.1 Në QSU "NËNË TEREZA" si rregull, profesionistët mjekësorë anëtarë të Urdhrit të Mjekut, Urdhrit të Farmacistit ose Urdhrit të Stomatologut punësohen nëpërmjet konkursit. Vlerësimi për personelin e lartë mjekësor bëhet prej një komisioni të përbërë nga Drejtori i Përgjithshëm (kryetari), Zv/ Drejtorët e Përgjithshëm, Shefi i Shërbimit përkatës, dhe një përfqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Edukimit në Vazhdim, ndërsa për personelin e administratës dhe personelin tjetër ndihmës respektohen dispozitat e Kodit të Punës.

24.2 Përzgjedhja mund të bëhet edhe kur paraqitet një kërkesë e vetme, vetëm në rastet kur provohet se është bërë njoftim publik për tre ditë rresht në një prej gazetave me tirazh më të madh. Në këto raste, në dosjen e praktikës përkatëse duhet të gjendet në çdo kohë një kopje e gazetës që ka shpallur njoftimin. Nëse kjo nuk gjendet, personi përgjegjës mban përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

24.3 Drejtori i Përgjithshëm, nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Edukimit në Vazhdim, pas kërkesës së argumentuar të Shefit të Shërbimit, harton kërkesat specifike të çdo vendi pune në QSU "NËNË TEREZA", para se të bëhet deklarimi i vendeve të punës.

24.4 Nga rregulli i mësipërm përjashtohen rastet kur merret në punë personel mjekësor me gradën profesor ose personel me kohë të pjesëshme.

24.5 Pedagogët ushtrojnë aktivitetin e tyre në bazë të një kontrate me QSU "NËNË TEREZA".

24.6 Profesionistët shëndetësorë, antar të Urdhrit të Infermierit, punësohen nëpërmjet platformës "Infermier për Shqipërinë", sipas rregullave dhe procedurave të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

25. Konflikti i Interesave



25.1 Mjeku i QSU "NËNË TEREZA" ndalohet të përdorë mjetet e saj për qëllime private apo përfitim vetjak, jashtë rregullave të parashikuara në këtë statut dhe në akte të tjera. Nëse kjo ndodh, atëherë ai/ajo largohet menjëherë nga puna.

25.2 Për të evituar konfliktin e mundshëm të interesave, shefat e shërbimit në QSU "Nënë Tereza", nuk mund të jenë pjesë e organeve drejtuese në institucione shëndetësore private.

~~Para emërimit të tyre, ata duhet të bëjnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore deklaratën përkatëse të shoqëruar me vërtetimin respektiv nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.~~

25.3 Për kategoritë e tjera të punonjësve, ku mund të lindë konflikt interesash, Drejtoria e QSU "NËNË TEREZA" harton një rregullore të posaçme sipas legjislacionit për konfliktin e interesit.

25.4 Mjeku që punon në QSU "NËNË TEREZA" me kohë të plotë mund të angazhohet me mësimdhënie në institucionet e arsimit shëndetësor publik pas miratimit nga Drejtoria e Përgjithshme.

25.5 Mjeku në QSU dhe familjarët e tij në gjini apo lidhje gjaku të afërt, bashkëshorti/ja dhe fëmijët nuk mund të konkurojnë dhe as të përzgjidhen në prokurime që organizon administrata e QSU.

26. Kushtet për Ushtrimet e Karrierës Profesionale në QSU "NËNË TEREZA"

QSU "NËNË TEREZA" siguron të gjitha lehtësitat dhe mbrojtjen e nevojshme, sipas legjislacionit përkatës, për çdo mjek apo punonjës që dëshiron të rrisë gradën e tij/saj shkencore.

Kreu IV

DISFOZITA TË FUNDIT

27. Procedura për miratimin e statutit:

27.1 Statuti i QSU "NËNË TEREZA"-së miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë.

27.2 Drejtoria e Përgjithshme ia paraqet këtë projekt – statut Bordit. Bordi, pasi e miraton në përbërje, i kërkon ministrit përgjegjës për shëndetësinë të shqyrtojë projektstatutin dhe

nisë procedurat për miratimin e tij, duke ia përcjellë për bashkëmiratim ministrit
përgjegjës për arsimin e lartë.

28. Hyrja në fuqi:

Ky statut hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dy ministrat.



nisë procedurat për miratimin e tij, duke ia përcjellë për bashkëmiratim ministrit
përgjegjës për arsimin e lartë.


28. Hyrja në fuqi:

Ky statut hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dy ministrat.



Shtojca 1:

Emblema OSU "NËNË TEREZA"



QENDRA SHITALORE UNIVERSITARE
"NËNË TEREZA"

